# Plani Pastoral i Kryepeshkopatës së Torontos



Për Besimtarët e Kryedioqezës së Torontos:

Kjo përmbledhje e shkurtër e Planit Pastoral për Kryedioqezën e Torontos na ofron mundësinë për të reflektuar në lutje sesi Jezusi na kërkon të jetojmë si dishepujt e Tij.
Plani ynë Pastoral është rrënjosur thellësisht në lutje, themeli i përpjekjeve tona.
Misioni ynë është i dyfishtë. Misioni ynë pastoral (i brendëshëm) është të nxisë dhe forcojë përvojën e besimit të Katolikëve të devotshëm, bazuar në modelin e Shën Pjetrit, të cilit Jezusi i tha, "Ushqeji delet e mija." Misioni ynë apostolik (i jashtëm) është të shpallë Ungjillin, si për besimtarët ashtu edhe për ata jashtë Kishës. Modeli ynë për këtë përpjekje është Shën Pali, i cili fillimisht e takoi Krishtin nëpërmjet konvertimit dhe më pas e shpalli Atë në të gjithë botën.

Plani ynë Pastoral fton çdo Katolik në kryedioqeze të reflektojë mbi rolin tonë si kujdestarë të dhuratave të shumta të Perëndisë, duke na thirrur në një konvertim të thellë të brendëshëm që na çon në një shpirt bujar, i cili shfaqet më i plotë në ndarjen e kohës dhe talenteve me të tjerët. Ne jetojmë çdo moment në një shpirt mirënjohje, duke kërkuar mënyra për të përdorur me efikasitet gjithçka që na është dhënë, në shërbimin e Perëndisë dhe të fqinjit.

Ne jemi të ndërgjegjshëm për temat kryesore do të enden nëpër të gjithë planin pastoral. Për ta bërë punën tonë në mënyrë efikase, ne duhet të sigurohemi që: të angazhojmë familjen, sidomos të rinjtë; të kremtojmë diversitetin tonë kulturor; të përdorim burimet me mençuri, dhe të komunikojnë në mënyrë efikase.

Kjo përmbledhje do të bazohet mbi imazhin biblik të hardhisë (Jezusi) dhe degët (populli i tij). Pesë prioritetet kryesore do të ndihmojnë në udhëheqjen e udhëtimit tonë.

Ju ftoj të mësoni më shumë rreth "udhërrëfyesit" për udhëtimin tonë duke vizituar një vend të veçantë në internet: vizito www.archtoronto.org/pastoral për të hyrë në planin e plotë pastoral përveç burimeve të tjera dhe mjeteve për refleksion.

Jam mirënjohës për rolin që ju luani në forcimin e komunitetit tonë. Të jeni të sigurt në lutjet e mija ndërsa punojmë së bashku me gëzim në hardhinë e Zotit.

Sinqerisht në Krisht,

+ Thomas Card. Collins
Tomas Kardinal Kollins
Kryepeshkop i Torontos

# Pesë Drejtime Kryesore

## Jeta Famullore

*"Dhe të gjithë ata që besonin rrinin bashkë dhe çdo gjë e kishin të përbashkët ..." Veprat E Apostujve 2:44*



Famullitë tona janë shtëpitë shpirtërore ku ne mblidhemi me njëri-tjetrin për tu takuar me Krishtin. Plani ynë kërkon nga ne që ti bëjmë 225 famullitë tona vendet të mirëseardhjes dhe mikpritjes, si për ata që janë me ne çdo javë edhe ata që kthehen në shtëpi pas shumë vitesh. Ne do të përgatisim veten me kujdes çdo javë për të kremtuar kungatën dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e vëmendëshme dhe aktive nga të gjithë. Ne do të mbështesim priftërinjtë dhe dhjakët tanë ndërsa ata na udhëheqin, dhe kur na kërkohet të ndihmojmë, ne do të përgjigjemi. Ne jemi të gjithë të përfshirë në këtë gjë së bashku. Është e rëndësishme që ne të kremtojmë famullitë e shumta tashmë të angazhuara në shërbesa ndihme dhe programe që mbështesin familjen, kishën shtëpiake. Ne mund të mësojmë nga shembulli i tyre i mrekullueshëm. Vizitoni www.archtoronto.org/parishlife për të parë tetë qëllimet që lidhen me "Jetën e Famullisë".

## Thirrjet

*"Ejani, më ndiqni," tha Jezusi, "dhe unë do t'ju bëj peshkatarë njerëzish." Ata i lanë menjëherë rrjetat dhe e ndoqën. - Mateu 4:19-20*



Perëndia na kërkon secilit prej nesh të "hedhim rrjetat tona" dhe të zbulojmë se për ku Ai po na udhëheq. Ne kemi nevojë për priftërinjët për të udhëhequr famullitë e kryepeshkopatës, dhjakët për t'i ndihmuar ata, anëtarë të kualifikuar për të mbështetur shërbesat tona të ndryshme dhe komunitete fetare në lulëzim. Çdo Katolik mund të jetë një përkrahës i thirrjeve përmes lutjes, inkurajimit dhe ftesave. Ne e njohim nevojën për të integruar programet tona formale të formimit të shërbesave, për të siguruar efektivitetin e tyre. Ne gjithashtu nuk mund të harrojmë priftërinjtë të cilët na kanë shërbyer me besnikëri me kalimin e viteve, duke u siguruar pasjen kujdes të tyre gjatë daljes në pension. Së bashku, ne mund të nxisim një kulturë thirrjesh në kryedioqezën tonë. Vizitoni www.archtoronto.org/vocations për të parë gjashtë qëllimet që lidhen me "Thirrjet".



## Ungjillizimi i Shoqërisë

*"Dilni në mbarë botën dhe i shpallni ungjillin çdo krijese;." - Marku 16:15*



"Ungjillizimi i Ri", e thënë thjesht, është të vlerësuarit e gëzimit që na sjell besimi në Krisht dhe ndarjen e saj me të tjerët. Ne do të përpiqemi për tu siguruar që zëri i besimit të dëgjohet në sheshin publik. Ne besojmë se bota ka nevojë për ungjillin e shpallur tani më shumë se kurrë. Praktikisht, ne kemi nevojë për të forcuar dëshminë tonë publike, dhe për të siguruar zëra të informuar Katolik duke punuar me shkollat , universitetet dhe institucionet e tjera. Ne do të shfrytëzojmë teknologjinë moderne për të marrë pjesë në dialog, përmes mediave fetare dhe laike, duke përqafuar mediat sociale dhe mjete të tjera që do të ngrenë lart ungjillin dhe do të ofrojnë instrumente të fuqishme të ungjillizimit nëpër të gjithë kryedioqezën tonë. Vizitoni www.archtoronto.org/evangelize për të parë pesë qëllimet që lidhen me "Ungjillizimin e Shoqërisë".







## Ndihma Katolike në Drejtësi dhe Dashuri

*"Fryma e Zotit, Perëndi është mbi mua, sepse Zoti më ka vajosur, ai më ka dërguar që të sjellë lajmin e mirë për të shtypurit, të lidh plagën e atyre me zemër të thyer, të shpall lirinë e atyre në robëri, dhe të liroj të burgosurit. "- Isaia 61:1*

Plani ynë pastoral na sfidon për të dëshmuar dhe për të shërbyer në mënyra të ndryshme dhe për të qënë mbështetës, aty ku ndodh padrejtësia: përmes kujdesit pastoral për të varfërit dhe të margjinalizuarit, për studentët në kampus, për ata që janë të burgosur, që kërkojnë strehim ose që po kalojnë vuajtje fizike apo shpirtëore. Ne mund ti bëjmë të gjithë këto duke punuar me famullitë tona, lëvizjet laike, institucionet katolike, kishat dhe shërbimet e ndryshme pastorale. Ne jemi mirënjohës për veprat e mira të arritura perms Organizatave Bamirëse Katolike dhe ShareLife, por na duhet të bëjmë më shumë. Ne i dëgjojmë fjalët në Meshë: "Shko në paqe, duke përlëvduar Zotin përmes jetës tënde." Si mund të jemi duart dhe fytyra e Jezsit në komunitetin tonë? Vizitoni www.archtoronto.org/outreach për të parë katër qëllimet e lidhura me "Ndihmën Katolike në Drejtësi dhe Dashuri".



**Katedralja si i Shenjë e Misionit tonë**

*"Në të edhe ju jeni duke u ndërtuar së bashku në një banesë për Perëndinë nga Fryma." - Efesianëve 2:20-22*

Katedralja Shën Mikaelit, është kisha nënë e kryedioqezës dhe, nëpërmjet shërbesës së kryepeshkopit, bashkon çdo Katolik vendas nën patronazhin qiellor të mbrojtësit të madh të besimtarëve, krye-ëngjëlli Mikael. Si prototip i jetës famullore, katedralja do të udhëheq rrugën e kujdesit pastoral dhe dëshmisë publike. Puna tashmë e filluar për ruajtjen dhe riparimin e katedrales do të vazhdojë. Ne gjithashtu kemi plane emocionuese për zhvillimin e zonës pranë katedrales - "Blloku Katedral" - në një vend adhurimi, mbledhje dhe ndihme, nëpërmjet Shkollës se Korit Shën Mikael, hapësirë për ndihmë ndaj të varfërve, dhe një qendër për tu mbledhur dhe për të mësuar, si dhe ofrojimin e mundësive për të angazhuar botën përmes mediave dhe arteve. Në një qytet me larmi kulturore si dhe një prani në rritje të mediave, Kisha Katolike duhet të bëhet një portë e besimit dhe ungjillizimit. Vizitoni www.archtoronto.org/cathedral për të parë katër qëllime lidhur me "Katedralen si Shenjë e Misionit tonë".

www.archtoronto.org

## Vazhdim I Bisedës

Mezi presim tju angazhojmë dhe ju në planin tonë pastoral. Na vizitoni në internet për të parë "udhërrëfyesin" e plotë së bashku me shumë mjete të tjera që na ndihmojnë gjatë udhëtimit. Ne tashmë kemi gjëra mahnitëse që po ndodhin në kishat tona – ne duam të kremotojmë dhe të ndërtojmë mbi këtë themel, duke pranuar që mund të bëjmë edhe më shumë:

a) Përfshihuni në famullinë tuaj vendase – shërbeni në altarin e Zotit tonë ose në këshillin famullor, bëhuni një lektor, anëtar i korit, ose visitor shtëpie. Ne inkurajojmë çdo Katolik të dallojë përfshirjen e tij lokale.

b) Vizitoni www.archtoronto.org/pastoral dhe ofroni përshtypjen tuaj mbi planin pastoral. Si e shihni këtë të shpalosur në jetën tuaj? Çfarë është duke bërë me sukses famullia juaj? Ku mund të përpiqet të ngrejë standartet?

c) Lutja – ne këkojmë që çdo Katolik ne kryedioqezë të ofrojë lutje për të gjithë popullin e Perëndisë që punon në hardhi çdo ditë. Ne mbështetetmi tek njeri-tjetri për të mbështetur shpirtërisht planin pastoral dhe ndihmojmë në dallimin e hapave përpara, si në nivel lokal ashtu edhe si kryedioqezë. Ne ja besojmë këtë plan Marisë, Nënës së Perëndisë, dhe i kërkojmë asaj të lutet që ne të mund të jemi dishepuj besnikë të Jezusit.

twitter.com/archtoronto

facebook.com/archtoronto

# Plani Pastoral i Kryedioqezës së Torontos

*Degët kryesore të planit tonë pastoral do të promovojnë qëllimet tona të kujdesit dhe ndihmës ndaj komunitetit. Ndërsa ne reflektojnë mbi këto qëllime, lutemi që  ky plan do të sjellë përfitime në jetën e çdo Katoliku të kryedioqezës tonë:*



## Jeta Famullore

*Dhe të gjithë ata që besonin rrinin bashkë dhe çdo gjë e kishin të përbashkët ...*
*- Veprat E Apostujve 2:44*

(i)  Festimi i Eukaristisë të së Dielës me pjesëmarrje të plotë, të vetëdijshëme dhe aktive nga besimtarët
(ii) Mundësi për lutje, formimim shpirtëror dhe pasuri
(iii) Një jetësë  e përbashkët në famullinë e cila ofron mireseardhje, mikpritje, & ndihmë



(iv) Udhëheqje e fortë pastorale në famullinë e cila nxit role të ndryshme dhe bashkëpunuese të shërbimeve pastorale
(v) Qeverise  efektive pastorale - struktura dhe komitete në famulli të cilat promovojnë administrimin dhe sigurojnë dhënien e llogarisë
(vi) Mbështetja e familjes, Kishës shtëpiake
(vii) Angazhimi për një ungjillizim të përtërirë - katekizmi dhe formimi në besim
(viii) Një dëshmi e fuqishme për një mision apostolik – shërbesë ndihme dhe shërbimi



## Thirrje

*"Ejani, më ndiqni," tha Jezusi, "dhe unë do t'ju bëj peshkatarë njerëzish." Ata i lanë menjëherë rrjetat dhe e ndoqën. - Mateu 4:19-20*

(i) Lutuni për thirrje
(ii) Kujdesuni për thirrjet e priftërisë së shuguruar dhe jetës fetare



(iii) Nxisni rolet e shërbesës pastorale të laikëve  brenda famullive dhe zyrave të kryedioqezës
(iv) Integroni programe të dallimit dhe formimin të priftërisë së shuguruar në Seminarin e Shën Augustinit
(v) Forconi programet e formimit dhe trajnimit të laikëve
(vi) Siguroni  formimin e vazhdueshëm të udhëheqësve pastoralë përmes programeve për klerin dhe laikët



## Ungjillizimi i Shoqërisë

*Dilni në mbarë botën dhe i shpallni ungjillin çdo krijese. - Marku 16:15*

(i)Bashkëpunimi me institucionet katolike akademike për të forcuar dëshminë intelektuale të kishës në kulturën tonë
(ii) Një partneritet i vazhdueshëm midis kryedioqezës, famullivë, shkollave tona Katolike   të financuara nga publiku, dhe studentëve që ndjekin shkollat   laike



(iii) Bashkëpunimi  me institucionet akademike katolike, për të promovuar arsimimin, katekizmin dhe formimin në besim dhe shenjtëri për pjesëmarrësit  në të gjitha fushat e shoqërisë.
(iv) Bashkëpunimi  me mediat katolike dhe agjencitë e komunikimit për të angazhuar kulturën përmes mediave dhe nismave sociale të komunikimit
(v) Bashkëpunimi  në formimin zhvillues dhe trajnim për të angazhuarit në apostullime intelektuale, komunikimet sociale dhe media







### Ndihma Katolike në Drejtësi dhe Dashuri

*Fryma e Zotit, Perëndi është mbi mua, sepse Zoti më ka vajosur, ai më ka dërguar që të sjellë lajmin e mirë për të shtypurit, të lidh plagën e atyre me zemër të thyer, të shpall lirinë e atyre në robëri, dhe të liroj të burgosurit . - Isaia 61:1*

(i) Të sigurojë nisma efektive ndihme të drejtesisë dhe dashurisë përmes organizatave bamirëse katolike
(ii) Të ofrojë shërbime efektive pastorale, shërbesë të kujdesit kishtar dhe pastoral
(iii) Të nxisë mbrojtje efektive të drejtësisë sociale
(iv) Të forcoje iniciativat e dhënies së ndihmës nga famullitë perms një bashkëpunimi më të madh me kryedioqezën.

### Katedralja si Shenjë e Misionit tonë

*Në të edhe ju jeni duke u ndërtuar së bashku në një banesë për Perëndinë nga Fryma.*
*- Efesianëve 2:20-22*

(i) Të restaurojë dhe përmirësojë bukurinë arkitektonike të katedrales së Shën Mikaelit
(ii) Të zhvillojë katedralen dhe bllokun katedral në një vend mbledhjeje, adhurimi, dhe dhënie të ndihmës
(iii) Të bashkëpunojë me bordin e shkollës Katolike dhe Shkollën e Korit në Shën Mikael
(iv) Të rigjallërojë katedralen & orën e katedrales si një qendër ungjillëzimi

## Rrënjosur në lutje. . .

Misioni ynë Pastoral ⟷ Misioni ynë Apostolik

- Jeta e famullisë
- Thirrje
- Ndihma Katolike në drejtësi dhe dashuri
- Ungjillizimi i shoqërisë
- Katedralja si shenjë e misionit tonë

- Angazhimi i familjes, sidomos i të rinjve
- Kremtimi i diversitet tonë kulturor
- Përdorimi i burimeve me mençuri
- Komunikimi në mënyrë efektive

**...Drej një administrimi të thellë**